

VENDIM
Nr.719, datë 20.10.2011

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË SHËRBIMEVE
TË MIDHJES DHE PESHKIMIT, SARANDË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkriren e Ndërmarrjes së Rritjes së Midhjes e Zënies së Peshkut, me qendër në Sarandë, e krijuar me vendimin nr.152, datë 8.4.1992 të Komitetit Ekzekutiv të rrethit Sarandë.
2. Krijimin e Drejtorisë së Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit, si institucion publik me qendër në Sarandë, në varësi të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.
3. Drejtoria e Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit drejtohet nga drejtori, i cili emërohet nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.
4. Rekrutimi i punonjësve të Drejtorisë së Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit bëhet sipas procedurave të përcaktuara në Kodin e Punës.
5. Drejtoria e Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit ka këto detyra:
 - a) Menaxhimin e Qendrës dhe Impianteve të Midhjes, në Sarandë;
 - b) Menaxhimin e porteve dhe qendrave të peshkimit në të gjithë territorin e vendit;
 - c) Menaxhimin e ekonomive të rasateve të peshkut, në Zvezdë, Korçë dhe të rasateve të koranit, në Lin, Pogradec;
 - ç) Grumbullimin e të dhënave statistikore të prodhimit të peshkut dhe molusqeve, si dhe të të dhënave social-ekonomike.
6. Drejtoria e Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit harton rregulloren e vet të funksionimit, ku përcaktohen të drejtat, detyrat dhe përshtimet e vendit të punës së çdo funksioni në këtë drejtori. Rregullorja miratohet nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.
7. Veprimtaria e Drejtorisë së Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit të financohet nga buxheti i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.
8. Struktura dhe organika e kësaj drejtorie miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozim të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.
9. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për ndjekjen e procedurave në QKR, për çregjistrimin si person juridik të Ndërmarrjes së Rritjes së Midhjes e Zënies së Peshkut, me qendër në Sarandë.
10. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha